



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d) dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 2.1 të Rregullores MF-02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, dhe nenit 17.1 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, si dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2019, mori këtë:

VENDIM

Neni 1

Këshilltarëve të Kuvendit, me qëllim të ushtrimit të funksionit të tyre në mënyrë sa më efektive, avancimit të punës së Kuvendit në përgjithësi dhe dërgimit të thirrjeve dhe materialeve të mbledhjeve në formë elektronike, u jepen në përdorim nga një lloptop.

Neni 2

1. Këshilltarëve të cilët kanë qenë edhe në mandatin e kaluar dhe që kanë mbajtur në përdorim lloptop, sipas mundësive të njëjtit ju jepen në përdorim.
2. Për këshilltarët tjerë të zhvillohen procedurat për blerjen e lloptopëve dhe dhënien e tyre në përdorim.

Neni 3

1. Këshilltarët e Kuvendit janë të obliguar t'i ruajnë, mirëmbajnë lloptopët dhe t'i përdorin për punët dhe aktivitetet në kuadër të fushëveprimtarisë së Kuvendit dhe trupave punues të Kuvendit si dhe për komunikim zyrtar.
2. Servisimi dhe mirëmbajtja teknike e lloptopëve bëhet në zyrën e Teknologjisë Informative e Komunës.

Neni 4

Këshilltari mban përgjegjësi për dëmtime fizike, humbje apo tjetërsim të lloptopit.

Neni 5

Lloptopët janë aset i Komunës, të njëjtit kthehen me rastin ndërprerjes eventuale të mandatit të këshilltarit përkatësisht me përfundimin e mandatit të Kuvendit.


Neni 6

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Administratës, Zyra e Teknologjisë Informative dhe Zyrtari i pranimit – depoisti.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 01-030/10-0007831/19
Podujevë,
30 janar 2019



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Cashi

[Signature]